



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-3918

Dt. 01.03.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Dan (Maliq) Gashi** nga Gjakova, për dhënen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të banimit individual, me etazhitet P+2, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr.2003/14 nenit 17, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesve: **Dan (Maliq) Gashi** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban si dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore me nr. 07-351-48339, dt. 06.02.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 1504-1, Z.K. Gjakovë - Qytet, në rrugën "Isa Boletini", në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiti i objektit është P+2, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S=270.38 m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): **S= 15.74 m²**
Kati i parë: (Sip,Bruto): **S= 92.84 m²**
Kati i dytë: (Sip,Bruto): **S= 92.84 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika I e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese shërbyese "HARP" N.P.SH. Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika I e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika I e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

$$517.65 \text{ €} + 192.62 \text{ €} = 710.27 \text{ €}$$

Pala do të paguaj vlerën totale nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në vlerë prej 710.27 € në dobi të Komunës së Gjakovës.

III. Pagesa e caktuar me këtë Aktvendim kryhet në Bankë (përzgjedhja e lirë), sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Nëse pagesa e kompenzimit e caktuar me këtë Aktvendim nuk bëhet brenda afatit të paraparë, pezullohet procedura e lëshimit të Lejës së Ndërtimit me arsyetim se kenë hequr dorë nga kërkesa për Leje Ndërtimi.

IV. Pa provën mbi pagesën e kompenzimit të caktuar me këtë Aktvendim nuk mund të ipet Leja e Ndërtimit.

Arsyetim

Kompenzimi i caktuar me këtë Aktvendim dhe lartësia e tij është llogaritur sipas nenit 5.1 dhe 5.2. të Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa nga shërbimet komunale numër 01 Nr 011-43964/2015 të datës 06.07.2015, ndërsa bruto dhe neto sipërfaqet janë llogaritur sipas projektit kryesor të prezantuar në këtë Drejtori.

Bazuar në regulativen ligjore në fuqi u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë juridike

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur mund të parashtron ankesë brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe dorëzohet përmes kësaj Drejtorie, duke e taksuar me 5 € taksë administrative.

Aktvendimi i dorëzohet :

1. Aplikuesit,
2. Organit kompetent.

Llogariti:

Mirlinda Mullahasani, inxh.dip.ark.

Kontrolloi:

Durrije Berisha, inxh.dip.ark.


Ushtruese e Detyrës së Drejtorit:

Elida Bejtullahu, inxh.dip.ark.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
Zona kadastrale Gj. Qytet ,
Parc. nr. 1504-2

PLAN SITUACIONI

Pronar i ng. nr.1504-2:
Dan Gashi



S_p (gabariti) = 84.70 m²

— gabariti i përdhësës

Gjakovë:
06.02.2017

Panor:
Fahir Bobi tek.

Vërtetues urbanist:
Mirliada Mullahasani, inxh.dip.ark.

KOPJE PLANI

Shk. zvog. 1: 1000

Poseduesi: GASHI JAN MALIQ

